



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri:** KSC-BC-2019-02

**Vendosi:** Paneli i përbërë prej një gjykatësi të vetëm  
Gjykatës Nikola Giju

**Administratore:** Dr. Fidelma Donlon

**Data:** 4 mars 2019

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

Version publik i redaktuar i

**URDHRIT**

**për Administratoren në lidhje me parashtrimin e përgjigjes**

---

**Parashtruesi**

Z. Ruzhdi Saramati

**GJYKATËSI I VETËM** është ngarkuar me shqyrtimin e kërkesës së parashtruar nga z. Ruzhdi Saramati ("Parashtruesi") më 23 shkurt 2019 ("Kërkesa për rishikim"),<sup>1</sup> për rishikimin e vendimit të Administratores në lidhje me ndihmën juridike, Ref: KSC/REG/IOR/1632, të datës 18 shkurt 2019 ("Vendim në lidhje me ndihmën juridike")<sup>2</sup> dhe në vijim lëshon këtë Urdhër për Administratoren në lidhje me parashtrimin e përgjigjes deri më 7 mars 2019.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 29 janar 2019, Parashtruesi i dorëzoi Administratores Formularin e Kërkesës për Ndihmë Juridike ("Kërkesa për ndihmë juridike")<sup>3</sup> si edhe një Formular të Deklarimit të Mjeteve Financiare ("Formulari i Deklarimit të Mjeteve"),<sup>4</sup> në të cilin deklaronte se nuk kishte mjete të mjaftueshme për të paguar për përfaqësimin e tij juridik në procedurat para Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe si rrjedhojë kërkonte miratimin e ndihmës juridike.
2. Më 18 shkurt 2019, Administratorja nxori vendimin në lidhje me ndihmën juridike për refuzimin e kërkesës për ndihmë juridike të dorëzuar nga Parashtruesi.<sup>5</sup>
3. Më 23 shkurt 2019, Parashtruesi dorëzoi kërkesën për rishikim, e cila u mor nga Kryetarja e Dhomave të Specializuara të Kosovës më 25 shkurt 2019.<sup>6</sup> Më 26

---

<sup>1</sup> KSC-BC-2019-02, F00001, Parashtruesi, *Kërkesë për rishikimin e vendimit*, 23 shkurt 2019, publike.

<sup>2</sup> KSC-BC-2019-02, F00004, Administratorja, *Parashtrim i Administratores në bazë të urdhrit të gjykatësit të vetëm të 27 shkurtit 2019 me 19 shtojca konfidenciale*, 28 shkurt 2019, Shtojca konfidenciale 4.

<sup>3</sup> KSC-BC-2019-02, F00004, Administratorja, *Parashtrim i Administratores në bazë të urdhrit të gjykatësit të vetëm të 27 shkurtit 2019 me 19 shtojca konfidenciale*, 28 shkurt 2019, Shtojca konfidenciale 1.

<sup>4</sup> KSC-BC-2019-02, F00004, Administratorja, *Parashtrim i Administratores në bazë të urdhrit të gjykatësit të vetëm të 27 shkurtit 2019 me 19 shtojca konfidenciale*, 28 shkurt 2019, Shtojca konfidenciale 2.

<sup>5</sup> KSC-BC-2019-02, F00004, Administratorja, *Parashtrim i Administratores në bazë të urdhrit të gjykatësit të vetëm të 27 shkurtit 2019 me 19 shtojca konfidenciale*, 28 shkurt 2019, Shtojca konfidenciale 4.

<sup>6</sup> DHSK, shpërndarë përmes postës së brendshme elektronike nga Njësia për Administrimin e Gjykatës, 25 shkurt 2019.

shkurt 2019, Kryetarja e Dhomave të Specializuara të Kosovës caktoi një gjykatës të vetëm për rishikimin e vendimit në lidhje me ndihmën juridike.<sup>7</sup>

4. Më 27 shkurt 2019, gjykatësi i vetëm lëshoi një urdhër për Administratoren për dërgimin e dokumenteve që kanë të bëjnë me vendimin në lidhje me ndihmën juridike deri më 1 mars 2019, si dhe për parashtrimin e përgjigjes ndaj kërkesës për rishikim deri më 7 mars 2019 (“Urdhri i gjykatësit të vetëm”).<sup>8</sup>

5. Më 28 shkurt 2019, Administratorja dorëzoi dokumentet përkatëse në përputhje me urdhrin e gjykatësit të vetëm, të përfshira në 19 shtojcat konfidenciale (“Dokumentet e Dorëzuara nga Administratorja”).<sup>9</sup> Gjithashtu, Administratorja njoftoi se përgjigja ndaj kërkesës për rishikim do të parashtrohej më vonë.<sup>10</sup>

## II. LIGJI I ZBATUESHËM

6. Në bazë të nenit 34(7) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, Zyra Administrative përfshin një Zyrë të Mbrojtjes e cila administron një sistem të ndihmës juridike për përfaqësimin e të akuzuarve të varfër ose pjesërisht të varfër para Dhomave të Specializuara të Kosovës.

7. Në bazë të rregullës 8 të Rregullores së Përkohshme për Ndihmë Juridike – Udhëzues Pune mbi kërkesat për caktimin e mbrojtësve dhe ndihmën juridike (“Rregullorja e Përkohshme për Ndihmë Juridike”),<sup>11</sup> pas kryerjes së vlerësimit të

---

<sup>7</sup> KSC-BC-2019-02, F00002, Kryetarja, *Vendim për caktimin e një gjykatësi të vetëm në përputhje me nenin 33(2) të Ligjit për rishikimin e vendimit të Administratores të datës 18 shkurt 2019 në lidhje me ndihmën juridike*, 26 shkurt 2019, publik.

<sup>8</sup> KSC-BC-2019-02, F00003, Gjykatësi i vetëm, *Urdhër Administratores për dërgimin e dokumenteve lidhur me vendimin KSC/REG/IOR/1632*, 27 shkurt 2019, publik.

<sup>9</sup> KSC-BC-2019-02, F00004, Administratorja, *Parashtrim i Administratores në bazë të urdhrin të gjykatësit të vetëm të 27 shkurtit 2019 me 19 shtojca konfidenciale*, 28 shkurt 2019.

<sup>10</sup> Parashtrim i Administratores, para. 6.

<sup>11</sup> Dokumentet e Dorëzuara nga Administratorja, Shtojca konfidenciale 7.

varfërisë sipas rregullës 7 të Rregullores së Përkohshme për Ndhmë Juridike, Administratorja merr vendim në lidhje me kërkesën për ndihmë juridike.

8. Në bazë të rregullës 11 të Rregullores së Përkohshme për Ndhmë Juridike, çdo vendim në bazë të Rregullores së Përkohshme për Ndhmë Juridike mund t'i nënshtrohet rishikimit, ndër të tjera, nga një gjykatës i vetëm i caktuar për atë qëllim prej Kryetares, pas marrjes së kërkesës së të dyshuarit ose të akuzuarit.

### III. DISKUTIM

9. Pas shqyrtimit të dokumenteve të dorëzuara nga Administratorja, gjykatësi i vetëm kërkon që Administratorja të marrë parasysh sa vijon në përgjigjen që do të parashtrijë në përputhje me Urdhrin e gjykatësit të vetëm.

10. Në Formularin e Dhënies së Pëlqimit të dorëzuar nga Parashtruesi, ai autorizon "[REDAKTIM] [...] të lëshojë të gjithë informacionin dhe dokumentacionin në lidhje me (numrin/numrat e llogarisë): [REDAKTIM] dhe [REDAKTIM] nr. [REDAKTIM]."<sup>12</sup> Gjithashtu, në Formularin e Deklarimit të Mjeteve, Parashtruesi deklaron se aktualisht merr [REDAKTIM]."<sup>13</sup>

11. Pas kërkesës së Zyrës së Mbrojtjes për informacion të mëtejshëm, veçanërisht në lidhje me dy llogaritë bankare të shënuara në Formularin e Dhënies së Pëlqimit,<sup>14</sup> Parashtruesi dorëzoi sa vijon:

- a) Deklarata bankare për periudhën e kërkuar lidhur me llogarinë nr. [REDAKTIM] në [REDAKTIM], me shpjegimin se kjo lidhet me [REDAKTIM]; deklaratat bankare tregojnë se nga kjo llogari janë bërë tërheqje me këtë numër karte bankare: [REDAKTIM];<sup>15</sup>

---

<sup>12</sup> Dokumentet e Dorëzuara nga Administratorja, Shtojca konfidenciale 3, f. 5.

<sup>13</sup> Dokumentet e Dorëzuara nga Administratorja, Shtojca konfidenciale 2, f. 37.

<sup>14</sup> Dokumentet e Dorëzuara nga Administratorja, Shtojca konfidenciale 10, f. 8.

<sup>15</sup> Dokumentet e Dorëzuara nga Administratorja, Shtojca konfidenciale 12, f. 5.

- b) Deklarata bankare për periudhën e kërkuar lidhur me llogarinë nr. [REDAKTIM] në [REDAKTIM], me shpjegimin se kjo lidhej me [REDAKTIM]; deklaratat bankare tregojnë se nga kjo llogari janë bërë tërheqje me këtë numër karte bankare: [REDAKTIM];<sup>16</sup>
- c) Deklarata bankare për periudhën e kërkuar lidhur me llogarinë nr. [REDAKTIM] në [REDAKTIM], me shpjegimin se kjo lidhej me [REDAKTIM]; deklaratat bankare nuk tregojnë numrin e kartelës bankare me të cilën janë bërë tërheqjet.<sup>17</sup>

12. Pas një kërkesë të mëtejshme të Zyrës së Mbrojtjes për dorëzimin e deklaratave bankare për dy llogaritë e cekura në Formularin e Dhënies së Pëlqimit,<sup>18</sup> Parashtruesi dorëzoi kopje të tri kartelave bankare:

- a) kartelë të [REDAKTIM] me nr. [REDAKTIM];<sup>19</sup>
- b) kartelë të [REDAKTIM] me nr. [REDAKTIM];<sup>20</sup>
- c) kartelë të [REDAKTIM] me nr. [REDAKTIM], për llogarinë bankare nr. [REDAKTIM].<sup>21</sup>

13. Numri i kartelës i njërës prej llogarive të Parashtruesit në [REDAKTIM]<sup>22</sup> është i njëjtë me numrin e shënuar prej tij në Formularin e Dhënies së Pëlqimit.<sup>23</sup> Ndonëse, siç tregohet më lart, deklaratat bankare përkatëse nuk jep numrin e plotë të kartelës bankare,<sup>24</sup> [REDAKTIM], ky numër, më së paku ka ngjashmëri të konsiderueshme me numrin e shënuar në Formularin e Dhënies së Pëlqimit ([REDAKTIM]).

---

<sup>16</sup> Dokumentet e Dorëzuara nga Administratorja, Shtojca konfidenciale 13, f. 5.

<sup>17</sup> Dokumentet e Dorëzuara nga Administratorja, Shtojca konfidenciale 15, f. 7.

<sup>18</sup> Dokumentet e Dorëzuara nga Administratorja, Shtojca konfidenciale 18, f. 5.

<sup>19</sup> Dokumentet e Dorëzuara nga Administratorja, Shtojca konfidenciale 19, f. 13, 15.

<sup>20</sup> Dokumentet e Dorëzuara nga Administratorja, Shtojca konfidenciale 19, f. 5, 7.

<sup>21</sup> Dokumentet e Dorëzuara nga Administratorja, Shtojca konfidenciale 19, f. 9, 11.

<sup>22</sup> krahaso: para. 12 a) më lart.

<sup>23</sup> krahaso: para. 10 më lart.

<sup>24</sup> krahaso: para. 11 a) më lart.

14. Numri i kartelës së llogarisë së Parashtruesit në [REDAKTIM]<sup>25</sup> është po kështu i njëjtë me numrin e shënuar prej tij në Formularin e Dhënies së Pëlqimit.<sup>26</sup> Gjithashtu, numri i llogarisë që gjendet në kartelën bankare<sup>27</sup> është i njëjtë me numrin e llogarisë që gjendet në deklaratën bankare përkatëse.<sup>28</sup>

#### IV. KONFIDENCIALITETI

15. Duke qenë se ky Urdhër i referohet përmbajtjes së shtojcave konfidenciale të përfshira në Parashtrimin e Administratores, ai lëshohet si urdhër konfidencial në përputhje me rregullën 82(1)(b) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave, deri në lëshimin e një versioni publik të redaktuar të këtij Urdhri.

#### V. VENDIM

16. Gjykatësi i vetëm në vijim:

**URDHËRON** Administratoren të marrë parasysh sa më lart në përgjigjen që do të dorëzojë deri më 7 mars 2019, në përputhje me Urdhrin e gjykatësit të vetëm.

/nënshkrim/

---

**Gjykatës Nikola Giju**

**Gjykatës i vetëm**

E hënë, 4 mars 2019

Në Hagë, Holandë.

---

<sup>25</sup> krahaso: para. 12 c) më lart.

<sup>26</sup> krahaso: para. 10 më lart.

<sup>27</sup> krahaso: para. 12 c) më lart.

<sup>28</sup> krahaso: para. 11 c) më lart.